



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 414/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Milazim Halitit kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

- I. MIRATOHET** si e bazuar ankesa e Milazim Halitit, kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).
- II. URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët e subjektit politik LDK në Vendvotimin 2501X/08R.
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit si në pikën –II- të këtij dispozitivit të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

Arsyetim

Me datë 27.06.2014 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Milazim Haliti, kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me numër 74 në të cilën thekson se 41 votat e tij i janë shënuar gabimisht kandidatit me numër 73. Këtë gabim sipas parashtruesit të ankesës e pranon edhe komisionari i vendvotimit 2501X/08R dhe si dëshmi ka bashkangjitur edhe FRK-në.

Bazuar në nenin 117.2 të LZP-së PZAP-i “Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme”

PZAP-i pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri hetimin e fletëvotimeve të kontestuara gjeti se:

ankesa është e bazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetime për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga Milazim Haliti, kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë hetimin e fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon se votat e tij i janë regjistruar kandidatit tjetër nga subjekti politik LDK.

Nga ekipi hetues i PZAP-it është hapur kutia e votimit me numër 2501X/08R e cila kuti ka qenë e mbyllur me 4 shirita anësor të sigurisë të cilët shirita kanë mbajtur këta numra: 095957, 095958, 095959 dhe 095960 poashtu kjo kuti e votimit ka qenë e mbyllur edhe me shiritin e sigurisë i cili gjendej në mes të kutisë së votimit me numër 095955 e i cili shirit nuk është prekur fare prandaj edhe ka mbetur i njëjti.

Pas hapjes së kësaj kutie PZAP-i ka gjetur se në këtë vendvotim ka pasur pa rregullsi dhe mospërputhje mes FRK-ve dhe votave të gjetura në këtë kuti të votimit duke ju shënuar gabimisht votat kandidatëve të tjerë.

PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve në këtë vendvotim për të gjithë kandidatët e subjektit politik LDK.

Andaj PZAP nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 414/2014 më datën 30.06.2014



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.